



OSHEE GROUP njofton mbi hapjen e vendit vakant:

Specialist pranë OSSH / Departamenti i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Aseteve / Sektori i Lëvizjes dhe Menaxhimit të Aseteve.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Miratimi i tërheqjes së transformatorëve nga reparti i riparimit pas kërkesës nga rajonet dhe vlerësimit të dokumentacionit përkatës që është i domosdoshëm të dërgohet: kërkesë, aktlëvizje , pv i avarisë, aktvendosje.
- Mbajta e datave mujore për sa i përket lëvizjeve (dëmtim – zëvendësim) të transformatorëve në një tabelë të përgjithshme, ku shënohet: data e dëmtimit dhe zëvendësimit, kabina, fideri, nënstacioni, fuqia, niveli i tensionit dhe barkodi përkatës i transformatorit të dëmtuar dhe atij të zëvendësuar.
- Komunikim i vazhdueshëm me rajonet për problematikat e ndryshme në lidhje me lëvizjen e transformatorëve : mungesë dokumentacioni, vonesë në dërgimin e tyre, pasaktësi të ndryshme etj.
- Komunikim i vazhdueshëm me repartin e riparimit ku pëfshihen: dërgimi i përditshëm i evidencave së transformatorëve të riparuar dhe në gjendje riparimi, prioritet për transformatorët që duhen riparuar, specifikime të ndryshme që vijnë nga rajonet ,etj
- Bërja e analizës vjetore,ku saktësohet numri në total i dëmtimeve, përqindjet e dëmtimeve në raport me fuqinë dhe tensionin si dhe arsyet e dëmtimit.
- Bërja e një plani shpërndarjeje të transformatorëve në rastet kur kemi emergjenca ose në rastet e gadishmërisë :sezonin veror, festat e fundvitit.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të zotërojnë Diplomë të arsimit të lartë.
- Të ketë aftësi shumë të mira të etikës dhe komunikimit.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Të ketë njohuri të mira për programet bazë të kompjuterit.
- Të kryej detyrat e ngarkuara me përgjegjësi.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV)
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion;

